

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesat nr. 29273/16 dhe 2398/18

Arben Kallo kundër Shqipërisë
dhe *Ledjo Yzeiri kundër Shqipërisë*
(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 16 maj 2024 si një Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar*,

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e Seksionit e Përkohshme*,

duke mbajtur në konsideratë kërkesën e mësipërme të depozituar më 22 maj 2020;

duke mbajtur në konsideratë kërkesat e mësipërme të depozituara në data të ndryshme paraqitur në tabelën bashkëlidhur;

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Lista e kërkesve paraqitet në shtojcë.

Ankesat e kërkesve në lidhje me aspekte të ndryshme të gjykimit në mungesë dhe procedurat civile, të tilla si kohëzgjatja dhe kushtet e ndalimit sipas neneve 3 dhe 6 të Konventës, iu komunikuan qeverisë shqiptare, e cila bëri parashtrime mbi pranueshmërinë dhe meritat.

Parashtrimet iu dërguan kërkesve, të cilët u ftuan të dorëzonin parashtrimet e tyre.

Me anë të shkresave të dërguara me postë rekomande, përfaqësuesit e kërkesve dhe kërkesit u ftuan t'u përgjigjeshin shkresave të Gjykatës. Vëmendja e kërkesve u drejtua te neni 37 § 1 (a) i Konventës, që parashikon se Gjykata mund të përjashtojë një kërkesë nga lista e saj e çështjeve, nëse rrethanat çojnë në përfundimin se kërkesi nuk ka për qëllim ta ndjekë kërkesën.

Megjithatë, në vijim nuk është dhënë asnjë përgjigje.

LIGJI

Duke pasur në konsideratë lëndën e ngjashme të kërkesave, Gjykata e vlerëson me vend që t'i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

Mbështetur në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se mund të konsiderohet se kërkesit nuk dëshirojnë të ndjekin më tej kërkesat (neni 37 § 1 (a) i Konventës). Gjithashtu, në mbështetje të nenit 37 § 1 *in fine*, Gjykata nuk konstaton asnjë rrethanë të veçantë në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, sipas përcaktimit në Konventë dhe Protokolleve të saj, ku kërkohet shqyrtimi i vazhduar i kërkesave.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

Deklaron bashkimin e kërkesave;

Vendos të përjashtojë kërkesat nga lista e saj e çështjeve.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 6 qershor 2024.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSSEKRETARE E PËRKOHSHME

Peeter Roosma
KRYETAR

SHTOJCË

Lista e kërkesave me anë të të cilave paraqiten ankesa, sipas neneve 3 dhe 6 të Konventës.

Nr.	Numri i kërkesës Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e shkresës së regjistruar të Gjykatës
1	29273/16 26.4.2016	Arben Kallo 1971	Thimjo Kondi Tiranë	5.12.2023 20.2.2024 (shpallur më 22.3.2024)
2	2398/18 5.1.2018	Ledjo Yzeiri 1975	Elton Lula Tiranë	18.1.2024 (shpallur më 31.1.2024)